

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT

"INTERNE"



**Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikimi i gjendjes aktuale**

Dhjetor, 2022

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (shtator – nëntor 2022) dhe një krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (tetor 2022). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Vlerësimet më të reja të institucioneve ndërkombëtare për rritjen globale janë të pafavorshme dhe tregojnë një rritje më të ngadaltë më 2022 dhe 2023, kryesisht si pasqyrim të pritshmërive për një ngadalësim të rritjes në SHBA dhe Europë, **pas së cilës pritet një përshpejtim në vitin 2024. Në të njëjtën kohë, pasiguria në lidhje me rritjen e ardhshme globale vazhdon të jetë e lartë dhe rreziqet përreth projeksioneve mbeten kryesisht në rënie**, dhe janë kryesisht të lidhura me një reduktim ose ndoshta një ndalim të plotë të furnizimeve me energji nga Rusia në Europë, në kontekstin e sanksioneve aktuale dhe të ardhshme¹, me një pasqyrim ndoshta më të fortë mbi aktivitetin ekonomik dhe çmimet. Për sa i përket **Eurozonës**, si partneri ynë kryesor tregtar, ekonomia në tremujorin e tretë shënoi një rritje të ngadaltë prej 2,3% (4,2% në tremujorin paraardhës), ndërkohë që prirja e uljes së shkallës së papunësisë vazhdoi dhe në tetor u reduktua në 6,5%² (6,6% në tremujorin e dytë). Inflacioni në Eurozonë, për herë të parë që nga qershori 2021, shënoi një ngadalësim dhe në nëntor është 10% me bazë vjetore (10,6% në tetor), me një rritje të ngadaltë të çmimeve të energjisë. Megjithatë, tregjet financiare presin shtrëngim të mëtejshëm të politikës monetare nga BQE-ja, kështu vlerësimet e fundit për lëvizjen e ardhshme të normës së interesit **EURIBOR-it njëmuor** janë rishikuar kryesisht në rritje krahasuar me pritjet e tetorit.

Nga këndvështrimi i treguesve të veçantë sasiorë për mjedisin e jashtëm, që janë të rëndësishme për ekonominë maqedonase, projeksionet për kërkesën e huaj efektive kanë ndryshuar vetëm për vitin 2023, për të cilin vlerësimet janë rishikuar në rënie në raport me projeksionet e tetorit, ndërsa vlerësimet për inflacionin e huaj efektiv janë rishikuar në rritje për të gjithë periudhën. Nga këndvështrimi i kursit valutor euro/dollar amerikan, për vitin 2022 pritet shkallë e njëjtë e vlerësimit të dollarit amerikan si në tetor, por më i fortë për vitin 2023, por zhvlerësim më i fortë i tij në vitin 2024. Sa u përket çmimeve të produkteve primare në bursat botërore, të shprehura në euro, për vitin 2022 janë bërë rishikime kryesisht të vogla në rritje në raport me projeksionet e tetorit dhe korrigjime në rritje ka edhe për vitin 2023, ndërsa për vitin 2024 rishikimet janë kryesisht në rënie. Lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve parësore vazhdojnë të jenë jashtëzakonisht të paqëndrueshme dhe nën ndikimin e fuqishëm të zhvillimeve në lidhje me konfliktin ushtarak ruso-ukrainas, i cili krijon pasiguri të madhe për dinamikën e ardhshme të tyre dhe efektet në ekonominë vendase, veçanërisht në afat të shkurtër.

Treguesit më të fundit të ekonomisë vendase tregojnë një pasqyrë makroekonomike, e cila është kryesisht në përputhje me projeksionet e tetorit, por në disa segmente vërehen devijime të caktuara. Sipas të dhënave të vlerësuara të publikuara të PBB-së, në tremujorin e tretë të vitit 2022 rritja reale e PBB-së u ngadalësua në 2% me bazë vjetore (4% në tremujorin e mëparshëm) dhe është në përputhje me rritjen e projektuar për këtë tremujor në ciklin e projeksionit të tetorit. Këto realizime janë nën ndikimin e efekteve negative të luftës në

¹ Sipas marrëveshjes së BE-së, G7-ës dhe Australisë, më 5 dhjetor 2022 hyri në fuqi kufizimi i çmimit maksimal të naftës bruto ruse në 60 USD për fuçi që do të transferohet nga deti dhe nëse nuk respektohet masa, operatorëve nga BE-ja do t'u ndalohej sigurimi, financimi dhe servisi i anijeve dhe një masë e ngjashme pritet për produktet e naftës, e cila është planifikuar të hyjë në fuqi më 5 shkurt 2023. Për më shumë, shikoni këtë [vjegëz](#) interneti.

² I referohet periudhës nga prilli 1998, kur publikohen të dhënat mujore për shkallën e papunësisë në Eurozonë.

Ukrainë mbi çmimet dhe ofertën, si dhe nga paqëndrueshmëria dhe pasiguria e theksuar në kushtet e jashtme ekonomike dhe financiare. Mesatarisht, në tre tremujorët e parë të vitit 2022, ekonomia shënoi një rritje reale prej 2,7%, që është afër pritshmërive nga projeksioni i tetorit (2,5%). E analizuar sipas komponentëve, rritja vjen tërësisht nga kontributi pozitiv i kërkesës vendase, në kushtet e rritjes dhe kontributit pozitiv të konsumit personal dhe të investimeve bruto, lidhur me rritjen e lartë të importeve dhe akumulimin e furnizimeve me energji, ndërkohë që konsumi publik ka një kontribut të vogël negativ. Nga ana tjetër, komponenti i eksportit neto shënoi kontribut negativ, në kushtet e rritjes më të lartë të importeve krahasuar me rritjen e eksporteve. Të dhënat e frekuencës së lartë për tremujorin e katërt të vitit 2022 që janë aktualisht në dispozicion, janë të pjesshme dhe janë të pamjaftueshme për të kuptuar situatën në tërësi. Për momentin, të dhënat e tetorit tregojnë një rënie të vogël reale vjetore të qarkullimit në totalin e tregtisë, kundrejt rritjes së vogël në tremujorin paraardhës dhe prirjeve të mëtejshme negative të prodhimit industrial. **Sa u përket ndryshimeve në çmimet e konsumit, në nëntor të vitit 2022 u arrit një shkallë vjetore e inflacionit prej 19,5%, që paraqet një ngadalësim në krahasim me realizimin e muajit të kaluar (19,8%), pas rritjes konstante prej më shumë se një viti. Shkalla vjetore e inflacionit në periudhën janar - nëntor 2022 është 13,8%.** Ngadalësimi i shkallës vjetore të inflacionit është tërësisht rezultat i ngadalësimit të rritjes së çmimeve të komponentit ushqimor, me stabilizimin e rritjes së çmimeve të komponentit të energjisë dhe rritjes mesatare të inflacionit bazë. Megjithatë, inflacioni vijon të jetë si pasojë e faktorëve të anës së ofertës, pra nga rritja e çmimeve të importit të ushqimeve dhe energjisë elektrike, përfshirë çmimin vendas të energjisë elektrike dhe atë të nxehtësisë, të cilat janë nën ndikimin e zhvillimeve në tregun botëror të energjisë. Rritja e tyre afatgjatë dhe më e fortë krijon efekte transferimi në çmimet e produkteve dhe të shërbimeve të tjera. Rishikimet në lidhje me lëvizjet e pritshme në supozimet hyrëse të jashtëm për projeksionin e inflacionit janë në drejtime të ndryshme, ndërkohë që vazhdon të jetë e theksuar pasiguria e lartë në lëvizjen e çmimeve botërore të produkteve primare në periudhën e ardhshme, me efekte të pasigurta ekonomike të luftës në Ukrainë.

Nga analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore, rezultojnë që vazhdojnë të mbahen në zonën e sigurt. Sa u përket të dhënave më të fundit në dispozicion nga sektori i jashtëm, deficit i tregtar, në tetor 2022, aktualisht është brenda pritshmërive për tremujorin e katërt, sipas projeksionit të tetorit, por periudha e vlerësimit është shumë e shkurtër për të nxjerrë përfundime më të sakta. Të dhënat për operacionet e këmbimit në fund të nëntorit 2022 tregojnë mundësinë e realizimit të hyrjeve neto nga transferet private, pak më të larta se sa pritej për tremujorin e katërt të vitit 2022, sipas projeksionit të tetorit. Realizimet në bilancin e pagesave për tremujorin e tretë të vitit 2022 tregojnë një suficit më të lartë në llogarinë rrjedhëse, krahasuar me projeksionin e tetorit, ndërkohë që hyrjet financiare neto të realizuara janë më të ulëta se sa pritej.

Sa u përket **lëvizjeve në sistemin monetar**, totali i **depozitave** në tetor u rrit për 0,4% me bazë mujore. Rritja vjen më së shumti nga rritja e depozitave të amvisërive dhe të sektorëve të tjerë, me një kontribut të vogël negativ të depozitave të ndërmarrjeve. Nga pikëpamja valutore, rritja është rezultat i kontributit të barabartë pozitiv të depozitave në valutë vendase (përfshirë paratë e depozitave) dhe depozitave në valutë. Në bazë vjetore, gjithsej depozitat në tetor 2022 janë më të larta për 4,1%, me një rritje vjetore të projektuar për tremujorin e katërt prej 3,9%, në përputhje me projeksionin e tetorit. **Kreditë totale** të sektorit privat shënuan rritje të vogël mujore prej 0,8% në tetor, për të cilën kontribuan kreditë e ndërmarrjeve dhe të amvisërive. Sipas strukturës valutore, rritja është rezultat më i madh i rritjes së kredive në valutë, me një kontribut më të vogël pozitiv të kredive në valutë vendase. Në bazë vjetore, rritja e gjithsej kredive në tetor ishte 10,1%, me rritjen e projektuar për tremujorin e katërt të vitit 2022 prej 9,2%, në përputhje me projeksionin e tetorit.


Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në periudhën janar - tetor 2022 është realizuar deficit prej 16.329 milionë denarë. Deficiti buxhetor është financuar plotësisht përmes huamarrjes së shtetit në tregun e jashtëm dhe vendas, ndërsa depozitat e shtetit në Bankën Popullore shënuan rritje. Deficiti buxhetor i realizuar për periudhën janar - tetor 2022 përfaqëson 38,2% të deficitit të planifikuar të buxhetit për vitin 2022.

Ndonëse treguesit më të fundit makroekonomikë janë përgjithësisht në përputhje me pritshmëritë, megjithatë, sipas vlerësimeve dhe vëzhgimeve më të fundit, mjedisi për zbatimin e politikës monetare mbetet i pafavorshëm. Rritja e çmimeve vendase u ngadalësua lehtë në nëntor, me një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes së komponentit ushqimor. Mirëpo, pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa vazhdon të jetë e theksuar për shkak të zhvillimeve ushtarake në Ukrainë. Sa i përket rritjes ekonomike, realizimet në tremujorin e tretë të vitit 2022, si dhe në tre tremujorët e parë të vitit janë afër atyre të projektuara. Të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë për aktivitetin vendas ekonomik në tremujorin e katërt janë të pamjaftueshme, por për momentin në plotësim të pritshmërive që ngadalësimi i rritjes do të vazhdojë deri në fund të vitit. Rezervat valutore mbahen në një nivel të përshtatshëm dhe në një zonë të sigurt, me lëvizje të qëndrueshme në tregun valutor në periudhën tetor-nëntor dhe një fluks të mëtejshëm të lartë valutor në tregun valutor. Në sektorin monetar, aktiviteti kreditor vazhdon të jetë solid dhe për momentin mbi projektimet, ndërkohë që dinamika e rritjes së totalit të depozitave është më mesatare dhe në përputhje me pritshmëritë.

Rritje e ngadaltë e aktivitetit ekonomik vendas në tremujorin e tretë të vitit 2022


Në tremujorin e tretë të vitit dolën në pah efektet e pafavorshme të krizës energjetike dhe rritja e shpenzimeve në sektorë të caktuar të ekonomisë, që solli ngadalësimin e rritjes ekonomike. Kjo ishte e dukshme përmes rënies së prodhimit industrial, kryesisht në segmentet më të forta energjetike (industria e metaleve dhe nxjerrja e mineralit të metaleve), si dhe përmes thellimit të rënies në ndërtimtari. Njëkohësisht, u forcua rimëkëmbja e sektorit të shërbimeve (tregtia, transporti dhe hoteleria), performanca e të cilit në të njëjtën periudhë të vitit 2021 ishte më e dobët për shkak të pandemisë Kovid 19, kur ishin në fuqi kufizimet dhe kushtet më të rrepta të udhëtimit. Për rrjedhojë, pas rritjes prej 4% në tremujorin e dytë, PBB-ja në tremujorin e tretë të vitit 2022 ka realizoi rritje reale më mesatare prej 2% në bazë vjetore. Ngadalësimi i rritjes është në përputhje me pritshmëritë nga projeksionet e fundit, kurse ngadalësimi pritet të vazhdojë edhe në tremujorin e fundit të vitit.

Странска ефективна побарувачка
(годишни промени во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Странска ефективна инфлација
(годишни стапки во %)



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Курс евро/САД-долар



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.


Për vitin 2022, vlerësimet e tetorit për një rritje prej 2,4% të **kërkesës së huaj efektive** janë ruajtur, ndërsa për vitin 2023, vlerësimet janë rishikuar në rënie dhe tregojnë një rënie minimale prej 0,2%, në vend të rritjes prej 0,3% të parashikuar në tetor. Kjo ndodh për shkak të pritshmërive për rritjen më të ulët ekonomike të pothuajse të gjithë partnerëve tanë kryesorë tregtarë, ku kontributin më të madh në korrigjimin në rënie e ka Gjermania³. Për vitin 2024 pritet një rimëkëmbje, ndërkohë që vlerësohet se rritja e kërkesës së huaj do të përshpejtohet dhe do të jetë 1,8%, siç pritej në tetor.

Nga ana tjetër, vlerësimet e **inflacionit të huaj** janë rishikuar mesatarisht në rritje për të gjithë periudhën e projeksionit dhe aktualisht pritet të rriten për 9,3%, 6,6% dhe 3,1% më 2022, 2023 dhe 2024 (përkatësisht 9,1%, 6% dhe 2,4% në tetor). Korrigjimet janë rezultat i pritshmërive për inflacion më të lartë në pothuajse të gjithë partnerët tanë të importit, me Gjermaninë, Bullgarinë dhe Poloninë që kanë dhënë kontributin më të madh për këto tre vjet.

Sa i përket kursit valutor **EUR/USD**, projeksionet e fundit tregojnë për një vlerësim të dollarit amerikan ndaj euros këtë vit dhe vitin e ardhshëm. Me këtë rast, sa i përket madhësisë së forcimit të vlerës së dollarit amerikan, ai është i pandryshuar për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 është rishikuar në rritje. Lëvizjet e këtyra pasqyrojnë në masë të madhe pritshmëritë për një interes më të madh për dollarin amerikan nga investuesit, për shkak të pasigurisë relativisht të lartë globale që rrethon aktivitetin ekonomik në vitin 2023, mes pritshmërive për shtrëngim të mëtejshëm të politikës monetare nga FED-i. Nga ana tjetër, për vitin 2024 është bërë një rishikim i vogël në rënie, gjatë të cilit pritet një zhvlerësim më i madh i dollarit amerikan.

³ Rritja e Gjermanisë projektohet në 1,6% më 2022, rënie prej 1% më 2023 dhe rritje prej 1,5% më 2024, kundrejt rritjes prej 1,6% më 2022, rënies prej 0,5% më 2023 dhe rritjes prej 1,4% më 2024 në tetor.

(квартален просек, евра/барел)



Pritshmëritë për **çmimin e naftës⁴**, të **shprehur në euro**, për vitin 2022 dhe 2023 janë rishikuar në rritje në tetor. Vlerësimet aktuale tregojnë një rritje pak më të lartë të çmimeve në vitin 2022, por një rënie më të vogël në vitin 2023. Lëvizje të tilla janë kryesisht rezultat i embargos së naftës ruse nga BE-ja duke filluar nga dhjetori i këtij viti dhe kufizimit të çmimit për transportin detar të naftës ruse⁵, si dhe pritshmëritë e investuesve për një reduktim më të madh të prodhimit të naftës nga vendet e OPEC+ sesa ishte parashikuar më parë. Nga ana tjetër, për vitin 2024, korrigjimet janë në drejtim rënës, ndërkohë që pritet një rënie minimale e çmimeve.

----- никел - октомври 2022



Sa u përket çmimeve të metaleve, është bërë një korigjim në rritje i vlerësimeve për periudhën 2022-2023, veçanërisht për vitin 2023. Në fakt, në vitin 2022 pritet një rritje pak më e lartë e çmimeve të bakrit dhe të nikelit në krahasim me atë të projektuar në tetor, ndërsa për vitin 2023 korigjimet janë më të mëdha, me ç'rast pritet një rritje, në vend të rënies së çmimit të nikelit, por një rënie më e vogël e çmimit të bakrit. Lëvizjet e këtilla në çmimet e metaleve janë kryesisht rezultat i pritshmërive të investuesve që Kina do të braktisë politikën "zero kovid", e cila do të pasqyrohej në kërkesë më të lartë se sa pritej më parë, veçanërisht në vitin e ardhshëm. Nga ana tjetër, për vitin 2024, rishikimet janë në kahen në rënie, ndërkohë që pritet një rënie pak më e madhe e çmimeve të metaleve.

Цени на пченицата и пченката во евра
(годишни промени во %)



Pritshmëritë për çmimin e **grurit dhe misrit të shprehura në euro** në bursat botërore për vitin 2022 janë rishikuar lehtësisht në rënie krahasuar me tetorin, me një rritje aktualisht më të ulët të çmimeve të tyre. Për vitin 2023, rishikimet janë në drejtime të ndryshme, kështu që vlerësimet e fundit tregojnë për një rënie më të madhe të çmimit të grurit dhe një rënie më të vogël të çmimit të misrit. Korrigjimi në rënie i grurit është në pjesën më të madhe rezultat i prodhimit rekord të lartë të grurit në Rusi, në kushtet e tejkalimit të problemeve që rrethojnë kanalën tashmë të krijuar të eksportit nga Ukraina përmes Detit të Zi. Në rastin e misrit, rishikimet në rritje janë rezultat i kursit valutës, pra i pritshmërive për një vlerësim më të madh të dollarit amerikan në raport me euron, me rënie të çmimeve të shprehura në dollarë. Për vitin 2024 pritet një rënie e çmimit të misrit, e ngjashëm me atë të projektuar në tetor dhe një rënie më e vogël e çmimit të grurit.


Едномесечен Еурибор
(квартален просек, во %)



Për EURIBOR-in njëmuor, rishikimet janë kryesisht në rritje, veçanërisht për vitin 2023. Në fakt, vlerësimet për vitin 2022 janë pothuajse të pandryshuara në krahasim me projeksionet e tetorit, me ç'rast ende pritet të jetë mesatarisht rreth 0%, ndërsa një rishikim në rritje është bërë për vitin 2023 dhe 2024, ku aktualisht pritet të jetë mesatarisht 2,17%, përkatësisht 2,08% (1,66%, përkatësisht 1,78% në tetor). Lëvizje të tilla janë në përputhje me pritshmëritë për një rritje të normave të interesit në mbledhjen e BQE-së në dhjetor, por në një masë më të vogël se më parë, dhe mbajtjen e tyre në këtë nivel gjatë vitit 2023.


Стапка на инфлација

(годишни придонеси во вкупната инфлација, во п.п.)



Në nëntor të vitit 2022, **rritja e çmimeve të konsumit vendas u ngadalësua, duke u rritur për 0,5% në bazë mujore** (1,4% në muajin paraardhës), me një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes së çmimeve në komponentin ushqimor. **Çmimet e ushqimeve** shënuan rritje minimale⁶ prej 0,3% (2,9% në tetor), që është kryesisht për shkak të çmimeve më të larta të mishit. Nga ana tjetër, çmimet e bukës dhe të drithërave ngecëm pak a shumë, ndërsa çmimet e frutave (kryesisht për shkak të efekteve sezonale) dhe të vajrave vazhduan të ulen. **Çmimet e energjisë** shënuan rritje prej 1% (0,9% në tetor), që më së shumti erdhi si pasojë e rritjes së çmimeve vendase të derivateve të naftës.

Придонеси кон годишната стапка на инфлацијата (во п.п.)



Inflacioni bazë në nëntor ishte 0,6% me bazë mujore, pas rritjes prej 0,1% në tetor. Rritja e çmimeve në komponentin bazë është më së shumti si pasojë e rritjes së çmimeve të produkteve për mirëmbajtjen rutinore të amvisërive dhe të higjienës personale e të pijeve joalkoolike, ndërsa çmimet e trafikut ajror vazhduan të ulen.

Shkalla vjetore e inflacionit në nëntor gjithashtu u ngadalësua në 19,5% (19,8% në tetor), pas një rritjeje të qëndrueshme prej më shumë se një viti. Ngadalësimi i shkallës vjetore të inflacionit është tërësisht rezultat i ngadalësimit të rritjes së çmimeve të komponentit ushqimor, me stabilizimin e rritjes së çmimeve të komponentit të energjisë dhe rritjes mesatare të inflacionit bazë. Kontributin më të madh në shkallën vjetore të inflacionit vazhdojnë

⁶ Për të zbutur trysnitë mbi çmimet e produkteve ushqimore, janë në fuqi disa vendime të qeverisë. Me Vendimin për kushtet e veçanta të tregtimit të mallrave të caktuara, të miratuar më 14 qershor 2022, Qeveria e RMV-së caktoi marzhin më të lartë tregtar të produkteve ushqimore bazë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, i cili fillimisht ishte i vlefshëm deri më 30 shtator, e më pas u vendos që zbatimi i tij të vazhdojë deri në fund të vitit. Sipas vendimit, për bukën e bardhë (të prerë në copa ose të plota), për sheqerin e bardhë dhe për vajin e lulediellit ushqimor, me përjashtim të kullimit të ftohtë, përcaktohet marzhi tregtar me lartësi deri në 5% në tregtinë me shumicë dhe deri në 5% në tregtinë me pakicë, ndërsa për miell gruri (lloji 400 dhe 500), për makarona dhe shpageti nga gruri i fortë, oriz të bardhë maqedonas, qumësht të përhershëm të lopës me përmbajtje yndyre 2,8%, 3,2% dhe 3,5% dhe vezë pule, përcaktohet marzhi tregtar me lartësi deri në 10% në tregtinë me shumicë dhe deri në 10% në tregtinë me pakicë. Gjithashtu, më 6 tetor u mor vendimi për kufizimin e marzhit tregtar në lartësinë deri në 10% për produktet bulmetit: gjizë, djathë të bardhë lope dhe të përzier, djathë, qumësht kosi, ajkë dhe kos, me vlefshmëri deri në fund të vitit. Më parë, më 20 korrik, Qeveria mori vendim për vazhdimin e zbatimit të masës për import pa doganë të vajit të lulediellit ushqimor deri në fund të vitit, që më parë vlente deri më 31 maj, kurse më 30 gusht u vendos për të hequr normat doganore nga 20% dhe 15% për qumështin dhe ajkën (të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar ose substanca të tjera ëmbëlsuese me një përmbajtje yndyre në masën që kalon 21%, por jo më shumë se 45% dhe të pakoncentruar dhe pa sheqer të shtuar me përmbajtje yndyre nga masë që kalon 10%, por nuk kalon 45% në ambalazh, përkatësisht masa neto e të cilit nuk i kalon 2,5 kilogramë), e vlefshme deri në fund të vitit. Nga ana tjetër, më 6 tetor, Qeveria mori vendim për ndërprerjen e vlefshmërisë së vendimit për kufizimin e eksportit të grurit dhe gjysmatares, miellit të grurit dhe gjysmatares dhe farave të lulediellit, për të përbushur detyrimin nga Marrëveshja për mekanizmat e sigurisë për ushqimin në Ballkanin Perëndimor, pra të mos ketë ndalesë për tregtimin e produkteve bazë bujqësore-ushqimore. Krahas kësaj, u ndërmorën masa edhe në sektorin e energjisë, për të ndikuar në uljen dhe stabilizimin e çmimeve të produkteve ushqimore vendore në periudhën e ardhshme. Kështu, më 9 shtator, qeveria mori një vendim sipas të cilit marzhi më i lartë i tregtimit të energjisë elektrike për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që kryejnë tregti në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë caktohet maksimalisht 10%, masë kjo e parashikuar të zgjasë gjatë sezonit të ngrohjes, pra deri më 15 prill të vitit pasardhës dhe më 30 tetor u mor vendim sipas të cilit, kompanitë që prodhojnë produkte ushqimore bazë, si vaj për gatim, bukë dhe produkte furre, miell, qumësht dhe bulmet e produkte mishi, do të lejohen të furnizohen me energji elektrike me çmim të subvencionuar prej 80 euro për megavat/orë.

Инфлација и цени на храната и енергијата (годишни промени, во %)



Извор: Државен завод за статистика и пресметки на НБРСМ.

ta kanë rritja e çmimeve të ushqimeve, veçanërisht të bukës dhe produkteve të drithërave. Sa u përket burimeve të energjisë, rritja është ndikuar nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike për amvisëritë (në janar dhe korrik të këtij viti⁷), plotësuar nga rritja e çmimeve të derivateve të naftës dhe lëndëve djegëse të ngurta⁸.

Shkalla bazë e inflacionit në nëntor është 9,5% me bazë vjetore (8,9% në muajin e mëparshëm), në kuadër të së cilës kontributin më të lartë pozitiv e kanë çmimet e shërbimeve në restorante dhe hotele, të shtuara me çmimet e produkteve për higjienën personale dhe mirëmbajtjen rutinë të amvisërive, pijeve joalkoolike, duhanit dhe trafikut rrugor, ndërsa çmimet e trafikut ajror kishin një kontribut negativ.

Странски ефективни* и домашни цени на храна и безалкохолни пијалаци (индекси, 2015=100)



* Ефективните странски цени на храна се добиени како пондеризиран збир од цените на храната во земјите што се најзначајни трговски партнери на Северна Македонија во доменот на увозот на храна.

Извор: ДЗС, Еуростат и пресметки на НБРСМ.

Në lidhje me lëvizjet e pritshme të supozimeve hyrëse të jashtme në projeksionin e inflacionit, rishikimet janë në drejtime të ndryshme, pra është bërë një rishikim në rritje i inflacionit të jashtëm efektiv dhe i rritjes së çmimeve të naftës, si dhe është bërë një rishikim në rënie në rritja e çmimeve të ushqimeve (misri dhe gruri). Në të njëjtën kohë, vazhdon të jetë e theksuar pasiguria e lartë në lëvizjen e çmimeve botërore të produkteve primare në periudhën e ardhshme, duke pasur parasysh efektet e pasigurta ekonomike të luftës në Ukrainë.

Në shtator të vitit 2022, rritja nominale vjetore e rrogës mesatare neto arriti në 12,8% (11,3% në muajin paraardhës). Rritja e rrogës minimale prej 18,5% në mars të vitit 2022, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore, vazhdon të kontribuojë kryesisht në rritjen vjetore të rrogave⁹, ndërsa një ndikim shtesë ka

⁷ Sipas vendimeve të Komisionit Rregullatër të Energjetikës të RMV-së (KRrE), çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal "EVN HOME" Sh.PK Shkup është rritur për 9,48% në janar dhe mesatarisht 9,9% në korrik të vitit 2022 (tarifa e ulët prej 8,8%, kurse tarifa e lartë mesatarisht 10,4%). Në fakt, nga 1 korriku, KRrE, për herë të parë prezantoi çmime të shkallëzuara për konsum në tarifën e lartë, përkatësisht prezantoi një model me 4 bllok tarifa. Krahasuar me të vetmen tarifë të lartë të mëparshme, çmimi i energjisë elektrike për bllokun 1 është më i lartë për 5,5%, blloku 2 për 10,3%, blloku 3 për 18,3% dhe blloku 4 për 138,7%. (<https://www.erc.org.mk/>).

⁸ Lidhur me lëndët djegëse të ngurta, Qeveria e RMV-së, më 20 korrik 2022, mori vendim për të kufizuar eksportin e druve të zjarrit dhe peletit, për të parandaluar dhe shmangur pasojat e shkaktuara nga kërkesa e shtuar e popullsisë për dru zjarri, të shkaktuara nga kriza energjetike globale. Gjithashtu, më 11 gusht u mor një vendim që përcakton marzhin më të lartë tregtar deri në 10% për dru zjarri dhe peleti, për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në tregtinë me pakicë, për të mbrojtur konsumatorët nga rritjet e pakontrolluara të çmimëve. Të dyja masat janë planifikuar të vlejné deri në fund të vitit.

⁹ Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e rrogës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 41/22) të marsit 2022, u bë rritje e jashtëzakonshme e rrogës minimale neto për 2806 denarë, në përputhje me marrëveshjen trepalëshe të arritur në mes të Qeverisë, sindikatave dhe punëdhënësve, ku shteti do të subvencionojë pjesën që ka të bëjë me kontributet (nga marsi 2022 deri në dhjetor 2022 në shumë prej 1197 denarë

Просечна исплатена плата
(годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.

Просечна исплатена месечна нето-плата по сектори
(номинални годишни стапки, во %)



Извор: ДЗС.

edhe rritja e një pjese të rrogave në sektorin publik¹⁰ në shtator të vitit 2022. Njëkohësisht, rritje vjetore të rrogave në shtator ka në të gjitha aktivitetet dhe rritjen më të lartë, si në muajt e kaluar, e shënuan aktivitetet e "artit, argëtimit dhe rekreacionit", "hoteleve dhe restoranteve" dhe "industrisë përpunuese".

Me rritjen e shpenzimeve të jetesës me bazë vjetore, **rroga reale neto në shtator shënoi një rënie prej 5% me bazë vjetore** (nga 4,7% që ishte një muaj më parë).

Ndryshimi nominal dhe real vjetor i rrogave, i realizuar në tremujorin e tretë të vitit 2022 (prej 11,8%, përkatësisht -4,6%) është në masë të madhe në linjë me ritmet e pritura për tremujorin e tretë sipas projeksionit të tetorit.


Në tremujorin e tretë të vitit 2022, rritja reale e PBB-së u ngadalësua në 2% me bazë vjetore (4% në tremujorin e mëparshëm), në përputhje me rritjen e projektuar për këtë tremujor në ciklin e projeksionit të tetorit.

Sa u përket shpenzimeve të PBB-së, rritja në tremujorin e tretë i detyrohet tërësisht kontributit pozitiv të kërkesës vendase, në kushtet e rritjes dhe kontributit pozitiv të konsumit personal dhe të investimeve bruto, lidhur me rritjen e lartë të importeve dhe akumulimin e inventarëve të karburanteve, në kushtet e ndikimeve të pafavorshme të luftës në Ukrainë, ndërkohë që konsumi publik ka një kontribut të vogël negativ.

për çdo muaj). Shuma e rrogave minimale në bruto, duke filluar nga marsi 2022 deri në shkurt 2023, është 26.422 denarë (më parë 22.146 denarë), përkatësisht rroga minimale në shumën neto është 18.000 denarë (paraprakisht 15.194 denarë). Gjithashtu, me ndryshimet dhe plotësimet e fundit u përcaktua metodologjia e re me të cilën do të harmonizohet rroga minimale në periudhën e ardhshme, pra nga marsi i vitit 2023, pra me rritjen për vitin e mëparshëm të rrogës mesatare të paguar në RMV dhe indeksit të shpenzimeve të jetesës - përkatësisht 50 % e rritjes nga secili tregues. Gjithashtu, përcaktohet se rroga minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e shumës së rrogës mesatare neto të paguar në RMV për vitin e mëparshëm.

¹⁰ Sipas rebalancit të Buxhetit, në rrogën e shtatorit ka rritje 15% për punonjësit në drejtësi, arsimin e mesëm dhe fillor dhe kujdesin ndaj fëmijëve, rritje 7% të rrogave për punonjësit në arsimin e lartë dhe 5% rritje të rrogave për punonjësit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në shëndetësi.

Бруто домашен производ
(реални годишни стапки, во %)




Извор: ДЗС и проекции на НБРСМ.

Разликите во серијата во остварениот период се должат на редовни ревизии на ДЗС.

Nga ana tjetër, komponenti i eksportit neto shënoi një kontribut negativ, në kushtet e rritjes më të lartë të importeve krahasuar me rritjen e eksporteve.

Nga këndvështrimi i prodhimit të PBB-së, rritja në tremujorin e tretë i detyrohet kryesisht kontributit pozitiv të grupit të aktiviteteve të "tregtisë, transportit dhe hotelerisë", të cilat ishin një nga aktivitetet më të prekura nga kriza e shkaktuar nga Kovid-19. Një kontribut pozitiv shtesë kanë aktivitetet që lidhen me pasuritë e paluajtshme, artin, bujqësinë, si dhe aktivitetet financiare dhe ato të sigurimit. Nga ana tjetër, një kontribut negativ vihet re në industri, ndërtim, si dhe në veprimtarinë e "administratës publike dhe mbrojtjes; arsimimit; shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale".

Индикатор на економска доверба и БДП



Извор: ДЗС и Европска комисија.

Duke pasur parasysh sasinë e kufizuar të të dhënave në dispozicion, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë i gjendjes së përgjithshme të ekonomisë në tremujorin e katërt të vitit 2022. Kur bëhet fjalë për perceptimet e subjekteve ekonomike për gjendjen e ekonomisë¹¹, rezultatet e hulumtimit të sondazhit për periudhën tetor-nëntor 2022 tregojnë perceptime më pak të favorshme krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2021, ndërkohë që janë pak më të favorshme në krahasim me tremujorin paraardhës. Perceptimet më pak të favorshme të subjekteve ekonomike krahasuar me vitin e kaluar mund të lidhen kryesisht me luftën në Ukrainë, me vazhdimin e zgjatur të niveleve të larta të inflacionit, si dhe

¹¹ Ka të bëjë me sondazhet e kryera nga Komisioni European për të matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik është marrë si një mesatare e ponderuar e treguesve të besimit të konsumatorëve dhe treguesve të besimit të sektorëve të veçantë ekonomikë (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).


me pasigurinë e theksuar të kushteve të jashtme ekonomike dhe financiare.

Sa u përket të dhënave me frekuencë të lartë në anën e ofertës, të dhënat e tregtisë dhe industrisë për tetorin 2022 janë në dispozicion.

Në tetor, **qarkullimi në tregtinë totale** shënoi një rënie të vogël reale me bazë vjetore, kundrejt rritjes së vogël të tremujorit paraardhës, në kushtet e rënies më të theksuar të tregtisë me pakicë, si dhe rënie të vogël u shënua edhe në tregtinë me shumicë. Nga ana tjetër, tregtia e mjeteve motorike po shënon rritje të lartë.

Në tetor, **prodhimi industrial** regjistroi një rënie reale prej 5,3% me bazë vjetore, që paraqet një thellim të rënies (në rënie për 1,8% në tremujorin e mëparshëm), mes rënieve dhe kontributeve negative nga industria përpunuese, minierat dhe furnizimi me energji elektrike. Në industrinë përpunuese vërehet rënie në disa nga aktivitetet tradicionale, ndaj kontributin më të madh negativ e ka prodhimi i produkteve të duhanit, prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve, prodhimi i produkteve ushqimore, si dhe prodhimin e metaleve. Nga ana tjetër, një kontribut pozitiv më i theksuar në industrinë përpunuese vihet re në aktivitetet në të cilat janë aktive kapacitetet e huaja eksportuese, si prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve dhe prodhimi i mjeteve motorike.


Treguesit në dispozicion për kërkesën agregate janë gjithashtu relativisht të kufizuar, që e bën të pamundur formimin e një vlerësimi më të saktë të lëvizjes së komponentëve individualë. Rreziqet e rritjes në këtë periudhë gjithashtu mbeten kryesisht në rënie, nën ndikimin e efekteve negative të zgjatura të luftës në Ukrainë mbi çmimet dhe ofertën, si dhe paqëndrueshmëria dhe pasiguria e theksuar në kushtet e jashtme ekonomike dhe financiare. Në këto kushte vazhduan të ndërmerren masa shtesë ekonomike për mbrojtjen e standardit të jetesës dhe likuiditetit të shoqërive¹², ndërkaq vazhdoi normalizimi i mëtejshëm i politikës monetare.



ИНДУСТРИСКО ПРОИЗВОДСТВО И ОСТАНАТИ ЕКОНОМСКИ ДЕЈНОСТИ												
	2019				2020				2021			
	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4
реални годишни промени во %												
Бруто домашен производ	2.8	6.1	4.3	2.5	-0.3	-15.4	-4.3	1.3	0.1	14.5	1.4	1.2
Индустриско производство	8.8	1.1	7.1	-1.3	-3.7	-25.0	-7.5	-2.3	-6.1	22.3	-3.5	-2.3
Извршени градежни работи	15.1	-3.3	3.0	5.3	6.3	-5.1	3.0	2.3	-1.1	-9.6	-10.8	-17.5
Високоградба	-9.3	5.1	23.7	-1.1	-8.5	-20.4	17.9	-8.6	18.5	5.3	-20.2	-20.9
Нискоградба	58.3	-8.0	-6.7	11.1	21.3	4.7	-6.2	11.1	-16.1	-16.9	-3.5	-15.2
Промет во трговијата - Вкупно*	13.9	12.8	15.3	15.5	-16.7	-30.6	-26.1	-24.3	0.9	22.5	16.9	10.4
Промет во трговијата на мало*	7.6	8.8	12.0	13.8	1.0	-18.6	-15.7	-15.5	-1.3	18.3	13.9	10.0
Промет во трговијата на големо*	18.0	16.0	18.1	17.3	-27.8	-40.1	-38.7	-36.3	3.7	27.9	28.4	19.6

* Реалните стапки на раст се пресметани од НБРСМ, со делjenje на номиналните стапки на раст со годишната инфлација, мерена според трошоците на живот. Податоците за трговијата во 2020, 2021 и 2022 година се прелиминарни податоци, додека податоците за БДП во 2020 година се прелиминарни, а за БДП во 2021 и 2022 година се проценети.
Извор: ДЗС и пресметки на НБРСМ.

¹² Nga marsi i vitit 2022 e në vazhdim u miratuan një numër më i madh masash për mbrojtjen e standardit të jetesës së qytetarëve dhe të likuiditetit të kompanive. Këto masa i referohen kryesisht kufizimit të marzheve, eksporteve si dhe heqjes së detyrimeve të importit për disa produkte ushqimore bazë. Gjithashtu, më 9 tetor 2022, Qeveria miratoi një paketë të re masash për mbështetjen financiare të kategorive të rrezikuara të qytetarëve, pensionistëve dhe kompanive dhe përmban masa të synuara për kategoritë më të cenueshme të qytetarëve; mbështetjen e synuar për institucionet



Të dhënat në dispozicion për lëvizjet e **konsumit personal** për tetorin 2022 janë të pamjaftueshme për një vlerësim më të saktë dhe për momentin kryesisht tregojnë për një ngadalësim të rritjes së tij. Në fakt, sa i përket burimeve të financimit të konsumit personal, rënia reale vjetore e pensioneve vazhdon¹³, edhe pse disi më e ngadaltë, si dhe rënia reale vjetore e kredisë për popullsinë. Treguesit afatshkurtër të dinamikës së konsumit personal janë gjithashtu më pak të favorshëm. Kështu, rënia në tregtinë me pakicë, importi i mallrave të konsumit vazhdoi në tetor, si dhe rënie kishte edhe në prodhimin vendas të mallrave të konsumit. Në tetor, vetëm të hyrat bruto nga TVSH-ja shënuan rritje, por më mesatare. Sa i përket treguesit të besimit të konsumatorit¹⁴, ai u referohet perceptimeve pak më të favorshme në periudhën tetor-nëntor 2022, krahasuar me tremujorin e tretë, me perceptime më pak negative për situatën financiare, si dhe pritshmëri më pak negative për situatën e përgjithshme ekonomike në vend dhe për konsumin e ardhshëm, e para së gjithash në pjesën e blerjeve të mallrave me vlerë më të lartë. Nga ana tjetër, treguesi i besimit të konsumatorit është më pak i favorshëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.


Në lidhje me të dhënat me frekuencë të lartë për **investimet bruto**, në tetor të vitit 2022 ka një rënie reale të investimeve kapitale shtetërore, si dhe rënie të prodhimit të përgjithshëm industrial. Gjithashtu vazhdoi rënia reale vjetore e kredisë afatgjatë të korporatave. Nga ana tjetër, importi i kapitalit qarkullues shënoi rritje në tetor dhe rritje, ndonëse më mesatare, u vu re edhe në prodhimin vendas të mallrave kapitale dhe në tatimin në fitimin. Sa u përket treguesve të besimit në industri dhe ndërtim për periudhën tetor-nëntor 2022, tregojnë prirje më pak të favorshme, krahasuar me tremujorin paraardhës

